



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

**Nr. i Dokumentit: 24.14.1-2018-08**

**RAPORTI I AUDITIMIT**  
**PËR KËSHILLIN E KOSOVËS PËR TRASHËGIMI KULTURORE PËR**  
**VITIN FINANCIAR TË PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2018**

**Prishtinë, maj 2019**

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Emine Fazliu, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Senver Morina (udhëheqës ekipi) dhe Besa Morina (anëtare ekipi), nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Astrit Bllaca.

## TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit .....	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm .....	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli .....	9
4 Qeverisja e mirë.....	12
5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	14
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA .....	17
Shtojca II: Letërkonfirmimi.....	20

## Përmbledhje e përgjithshme

Raporti përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturor për vitin 2018, i cili përfshin Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare Vjetore. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2018 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 30.01.2018.

Auditimi është fokusuar në:



Niveli i angazhimit për të kryer auditimin është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturor.

### Opinion i Auditorit të Përgjithshëm


#### Opinion i pamodifikuar

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2018 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.*

Më gjerësisht shih pjesën 2.1 të këtij raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e opinioneve, sipas SNISA-ve.

## Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore



## Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2018

Udhëheqësi Ekzekutiv është pajtuar me gjetjen dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresoj rekomandimin e dhënë.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson bashkëpunimin e menaxhmentit dhe personelit të KKTK-së gjatë procesit të auditimit.

# 1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase; dhe
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Ne kemi analizuar veprimtarinë e Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturor (KKTK), nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë dhe që e mbështesin opinionin e AP-së.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

---

## 2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm

Auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese dhe cilësinë e saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV, përfshirë deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

### 2.1 Opinioni i auditimit

#### Opinion i pamodifikuar

Ne kemi audituar PFV-të e Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturorë për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, shpalosjet dhe raportet tjera përcjellëse.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

#### Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

#### Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV

Udhëheqësi Ekzekutiv dhe Zyrtari Kryesor Financiar janë përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar, dhe për kontrollet e brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

---

Kryetari i Këshillit është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të KKTK-së.

### **Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve**

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave të SNISA-ve, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbuloj çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

## **2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim**

Nga Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturorë kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFPP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullat Financiare nr. 01/2013 dhe 02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK);
- Planin final të prokurimit; dhe
- Raportet për obligimet e papaguara.



Lidhur me PFV-të, dhe kërkesat tjera për raportim të jashtëm nuk kemi ndonjë çështje për të ngritur.

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në Ministrinë e Financave, konsiderohet e saktë

### 3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e buxhetit, menaxhimin e kontratave, burimet njerëzore, pasuritë dhe detyrimet.

#### Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi shpenzimet në përgjithësi janë të përshtatshme dhe janë duke u zbatuar në mënyrë efektive.

##### 3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

**Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final <sup>1</sup>	2018 Realizimi	2017 Realizimi	2016 Realizimi
<b>Burimet e Fondeve:</b>	<b>218,288</b>	<b>175,999</b>	<b>152,457</b>	<b>152,138</b>	<b>178,836</b>
Granti i Qeverisë -Buxheti	218,288	175,999	152,457	152,138	178,836

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 42,289€. Ky zvogëlim është si rezultat i vendimeve të Qeverisë për kursime buxhetore.

Në vitin 2018, KKTK ka shpenzuar 87% të buxhetit final ose 152,457€, me një përmirësim prej 7% krahasuar me vitin 2017. Më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

pen<sup>1</sup> Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2018 Realizimi	2017 Realizimi	2016 Realizimi
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:</b>	<b>218,288</b>	<b>175,999</b>	<b>152,457</b>	<b>152,138</b>	<b>178,836</b>
Pagat dhe Mëditjet	130,320	89,183	89,183	108,338	91,801
Mallrat dhe Shërbimet	85,418	85,418	62,407	42,761	85,084
Shërbimet komunale	2,550	1,398	867	1,038	1,951

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore përfshirë arsyet dhe ndikimin që kanë pasur janë dhënë si në vijim:

- Buxheti final për paga dhe mëditje në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 41,137€ me vendim të Qeverisë, ngase Bordit prej shtatë anëtarësh, i kishte përfunduar mandati në fund të korrikut 2018. Buxheti final për këtë kategori është shpenzuar 100%;
- Buxheti final për mallra dhe shërbime nuk kishte ndryshim me buxhetin fillestar, ky buxhet shpenzuar vetëm 62,407€ apo në masën prej 73%. Mungesa e Bordit ka ndikuar që niveli i shpenzimeve për këtë kategori të jetë i ulët; dhe
- Buxheti final për shpenzimet komunale në krahasim me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 1,152€. Buxhetin final ishte shpenzuar në vlerë prej 867€ apo 62% e buxhetit. Arsyeja e realizimit të ulët të buxhetit për këtë kategori ishte se, pagesat e ujit, mbeturinave dhe rrymës mbulohen nga Ministria e Administratës Publike.

### Rekomandime

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

## 3.2 Pagat dhe mëditjet

Pagat dhe mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar të pagesave që menaxhohet nga MAP dhe MF. Kontrolltet kyçe që e konfirmojnë saktësinë dhe plotësinë e pagesave janë listat e pagave të nënshkruara nga udhëheqësit e njësive organizative.

Shpenzimet për paga dhe mëditje gjatë vitit 2018 ishin 89,183€ apo në masën prej 100%. Numri i aprovuar i të punësuarve në KKTK ishte 16, ndërsa numri aktual i të punësuarve në fund të vitit ishte 7 punonjës (mungesa e shtatë anëtarëve të bordit si dhe dy staf administrativ).

### Rekomandime

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

### 3.2.1 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime dhe shërbime komunale në vitin 2018 ishte 86,816€. Prej tyre ishin shpenzuar 63,274€ apo në masën prej 72%.

Ato kanë të bëjnë kryesisht me shpenzime të udhëtimit, furnizim për zyre, shpenzime për telefoni mobile, shpenzimet komunale si dhe shërbime/furnizime të tjera.

#### **Rekomandime**

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë

### 3.3 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Vlera neto e pasurive të KKTK-së e shpalosur në PFV ishte 12,671€. Prej tyre vlera e pasurive kapitale mbi 1,000€ ishte 8,882€ dhe vlera e pasurive jokapitale nën 1,000€ ishte 3,789€. Ne kemi rishikuar nëse procesi i regjistrimit dhe mënyra e mbajtjes së evidencave është në pajtueshmëri me kërkesat e rregullës së MF-Nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore, procesin e inventarizimit, zhvlerësimin dhe ekzistencën fizike të pasurive.

#### **Rekomandime**

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

### 3.4 Obligimet e papaguara

Pasqyra e obligimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2018 ishte 555€, të cilat janë bartur për t'u paguar në vitin 2019.

#### Çështja A1<sup>2</sup> - Mos protokollimi i faturave të pranuar

**Gjetja** Sipas nenit 24 pika 1,3 të Rregullës Financiare Nr.01/2013 MF për shpenzimin e parasë publike, kërkohet që 'fatura të protokollohet dhe të evidentohet në librin e faturave'. Gjatë vitit 2018 të gjitha faturat e pranuar nuk kishin datën e pranimit si dhe nuk ishin të protokolluara nga KKTK.

Menaxhmenti i KKTK-së nuk kishte vendosur kontrolle për pranimin dhe protokollimin e faturave të pranuar.

**Rreziku** Mos protokollimi i faturave e rritë rrezikun e humbjes apo pagesës së dyfishtë të të njëjtës faturë.

**Rekomandimi A1** Udhëheqësi Ekzekutiv duhet të vendosë kontrollet e brendshme për qarkullim të dokumentacionit si dhe të sigurojë se faturat protokollohen në momentin e pranimit.

## 4 Qeverisja e mirë

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmerr veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK nga ana e organizatave buxhetore monitorohet edhe nga plotësimi i listave kontrolluese të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat i dorëzohen Ministrisë së Financave.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentët tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

<sup>2</sup> Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja

---

## Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

KKTK në përgjithësi ka kontrollë të mira në raport me obligimet ligjore të saj. Menaxhimi financiar dhe kontrolli ka dëshmuar proces të mirë të rishikimit dhe siguri në zbatimin e legjislacionit dhe proceseve të tjera të kontrollit. Sfidë kryesore me të cilën ishte përballur KKTK ishte mos funksionimi i Bordit prej korrikut të vitit 2018.

KKTK kishte zbatuar rekomandimet e dhëna për vitin 2017 si dhe ka përgatitur regjistrin e rreziqeve me të gjitha masat, duke identifikuar të gjitha rreziqet domethënëse që mund të kenë ndikim tek organizata në lidhje me arritjen e objektivave të saj. Gjithashtu ishte kryer një auditim që ndërlidhet me funksionimin e KKTK-së, nga Departamenti për Auditim të Brendshëm i Ministrisë së Financave.

### 4.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Sipas UA Nr. 23/2009 për themelimin dhe funksionimin e Njësisë së Auditimit të Brendshëm (NJAB), Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturorë nuk i plotëson kriteret për themelimin e kësaj njësie.

Megjithatë, KKTK-ja kishte bërë kërkesë në Ministri të Financave për kryerjen e Auditimit të Brendshëm. Në bazë të kësaj kërkesë është kryer auditimi i brendshëm për vitin 2017 dhe katër mujorin e vitit 2018 që ndërlidhet me funksionimin e KKTK-së nga Departamenti për Auditim të Brendshëm.

#### **Rekomandime**

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

### 4.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Për të pasur një planifikim të mirë, për të mbikëqyrë aktivitetet në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje efektive, menaxhmenti ka nevojë të posedoj raporte të rregullta. Llogaridhënia si proces është pranimit i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën.

Menaxhmenti, ka zbatuar një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet funksionojnë si duhet, ne kemi vërejtur se masat e aplikuara janë të mira dhe efektive dhe mundësojnë një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

## **Rekomandime**

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

## **5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve**

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e vitit 2017 ka rezultuar në pesë rekomandime. KKTK kishte përgatitur një plan veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2018, pesë rekomandimet e dhëna ishin zbatuar, shihni në Tabelën 4.

## **Rekomandime**

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2018

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2017	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1	Planifikimi i Buxhetit	Kryetari i Këshillit duhet të sigurojë menaxhim efikas të buxhetit. Bazuar në shkaqet e realizimit të ulët të buxhetit, të marrë veprime përmirësuese, ndërsa performanca buxhetore të monitorohet në baza të rregullta dhe të merren veprime kur është e nevojshme	Realizimi i buxhetit final prej 87%, me një përmirësim prej 7% krahasuar me vitin 2017.	Rekomandim i zbatuar
2	Paga e Meditje	Kryetari i Këshillit duhet të sigurojë që të gjitha dosjet e personelit janë të plotësuar në përputhje me legjislacionin dhe të azhurnohen me kohë. Po ashtu, fokus i veçantë duhet t'i kushtohet vlerësimit të rregullt të stafit dhe përshkrimit të qartë të detyrave dhe përgjegjësive për të gjithë punonjësit e organizatës	Nga dosjet e testuara nuk kemi vërejtur ndonjë parregullsi.	Rekomandim i zbatuar
3	Pasurite	Kryetari i Këshillit duhet të sigurojë kontroll efektive në menaxhimin e pasurive të saj përmes procesit të inventarizimit. Inventarizimi duhet të kryhet në fund të çdo viti fiskal dhe duhet të shërbej si mekanizëm për të konfirmuar gjendjen fizike, saktësinë, plotësinë dhe të krahasoj gjendjen me regjistrat e pasurive që i mbahen nga Këshilli.	KKTK për vitin 2018 kishte kryer inventarizimin.	Rekomandim i zbatuar
4	Progresi ne zbatimin e rekomandimeve	Kryetari i Këshillit duhet të sigurojë fillimisht përgatitjen e një plan veprimi ku përcaktohen saktë afatet kohore për zbatimin e rekomandimeve të bëra nga AP, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme. Zbatimi duhet të monitorohet në vazhdimësi me qëllim të përmbushjes së rekomandimeve në plotësi	Të gjitha rekomandimet janë zbatuar, bazuar në planin për zbatimin e tyre.	Rekomandim i zbatuar
5	Raportimi menaxherial ,llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut	Kryetari i Këshillit duhet të sigurojë se është deleguar përgjegjësia për hartimin e regjistrat të rrezikut nëpër sektorët përkatës dhe njëkohësisht të sigurojë monitorim efektiv dhe raportim tremujor për zbatimin e kërkesave në këtë fushë.	Kanë hartuar regjistrat të rreziqeve dhe është bërë monitorimi i tyre.	Rekomandim i zbatuar

---

Nr	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2018
1	Obligimet e papaguara	Udhëheqësi Ekzekutiv duhet të vendosë kontrollet e brendshme për qarkullim të dokumentacionit si dhe të sigurojë se faturat të protokollohen në momentin e pranimit.



---

## Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

### Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

### Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

---

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

## Shtojca II: Letërkonfirmimi



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo – Republic of Kosovo

Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore  
Savet Kosova za Kulturno Nasledje / Kosovo Council for the Cultural Heritage

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO			
KËSHILLI I KOSOVËS PËR TRASHËGIMI KULTURORE / KOSOVO COUNCIL FOR CULTURAL HERITAGE			
Primitur / Dërguar Printed / Delivered	03.05		viti year
28			2018
Nr. Prot. Bil. Prot. No. Prot.	28/18	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
			1

## LETËR E KONFIRMIMIT


Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2017 dhe për zbatimin e rekomandimeve

**Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit**

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017 (në tekstin e mëtejme "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

  
z. Isuf Koci, udhëheqës ekzekutiv

Data: 03.05.2018, Prishtinë